

## Ismail Kadare – Kristal

-Pyetje me shtjellim-

-shënime-

Pse autori ka vënë në titull të poezisë metaforën kristal?

Gjej disa nga ngjashmëritë fizike, estetike etj. ndërmjet kristalit dhe dashurisë së humbur.

Shkruaj mendimin që të lind nga krahasimi i saj me këtë gur të çmuar.

Rendit tre tipare të lirikës erotike të Kadaresë, duke u ndalur në poezinë e mësipërme si dhe duke pasur parasysh krijimtarinë poetike të autorit.

Gjej detajet që duket sikur vizatojnë peizazhin e shpirtit të heroit lirik.

Si do ta përcaktoje një shpirt të tillë: *të bukur, të trazuar, të pakuptueshëm, të pasur, të dyshimtë, ...?*

Shpreh mendimin tënd duke shfrytëzuar detajet që gjete.

-shënime-

Cilën nga fjalët e poezisë do të vendosje menjëherë pas fjalëve hon dhe hedh, duke pasur parasysh aliteracionin me shkronjën h?

Ç'efekt krijon përmendja e menjëhershme pas tyre e fjalës lumnajë? Argumento mendimin tënd..

Ç'kuptim ka fakti që heroi lirik mund të mos gjejë hon ku ta hedhë?

Pse menjëherë pastaj përmendet lumnaja?

Pse kjo poezi është nga më përfaqësueset e lirikës intime të Kadaresë?

Gjeni figurën mbi të cilën është bazuar ndërtimi i strofës së parë.

Argumentoni pse kjo është figura mbi bazën e së cilës është ndërtuar gjithë poezia.

Në strofën e parë përmendet dy herë fjala vdekje.

A kemi të bëjmë realisht me një vdekje fizike?

-shënime-

Pse flokët përmenden të fundit?

Cilat janë shkallët e harrimit, por të marrim parasysh renditjen e fjalëve:

*s'shihemi, harroj, vdes kujtimi*

Heroi lirik kërkon ta lëshojë kufomën e dashurisë në një strofë a notë, a një brilant.

**Është e vërtetë që kërkon ta harrojë atë?**

*(mundohuni të kapni kuptimin e tre fjalëve, për t'u përgjigjur)*

Argumentoni përfundimin e mësipërm edhe me fjalën "mermer" që përdoret në një strofë më poshtë.

Cili të jetë kuptimi i vargjeve:

*Mos duhet vall' prap' të të mbart  
Gjysmë të vdekur, gjysmë të gjallë?*

Gjeni një fjalëformim tipik të Kadaresë.

-shënime-

**Gjeni lojën që bën Kadareja me kuptimet e jetës dhe vdekjes në vargjet:**

*Të gjej një fushë a një lulënjë  
Ku butësisht posi polen  
Gjithkund, gjithkund të të shpërndaj.*

**Ku qëndron mashtrimi në vargjet e mëposhtme:**

*Të të mashtroj ndoshta kështu  
Dhe të të puth, të ik pa kthim*